



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Lënda: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 26 shkurt 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Trupin Gjykues që të marrë
Masa për të Siguruar Perceptimin e Paanshmërisë së Procedurës dhe për të
Shmangur Dëmtimin e Mbrojtjes**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 3(2), 21(2), 21(4), 40(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 20 dhe 127(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykues lëshoi urdhrin lidhur me zhvillimin e gjykimit ("Urdhri për Zhvillimin e Gjykimit") në të cilin, midis të tjerash, përcaktohen procedurat që rregullojnë marrjen në pyetje të dëshmitarëve.¹

2. Më 19 prill 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit dhe Mbrojtja e Kadri Veselit ngritën disa pika në lidhje me marrjen në pyetje nga Trupi Gjykues të një dëshmitari sa i përket materialit që nuk është pranuar si provë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga palët.²

3. Më 20 prill 2023, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër gojor lidhur me kuadrin e marrjes në pyetje, duke hedhur poshtë argumentin e Mbrojtjes ("Urdhri Gojor").³

¹ F01226/A01, Trupi Gjykues, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023.

² Transkripti i seancës, 19 prill 2023, konfidencial, f. 3253, rreshti 19 deri në f. 3260, rreshti 8.

³ Transkripti i seancës, 20 prill 2023, f. 3263, rreshti 12 deri në f. 3269, rreshti 16.

4. Më 17 maj 2023, pas një kërkesë nga Mbrojtja e Hashim Thaçit, Mbrojtja e Rexhep Selimit dhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit,⁴ Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesën për leje për apelimin e Urdhrit Gojor (“Vendimi për Leje për Apel”).⁵
5. Më 4 korrik 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin, me anë të të cilit rrëzoi apelin kundër Urdhrit Gojor (“Vendimi i Apelit”).⁶
6. Më 19 mars 2024, pas një kërkesë të Mbrojtjes,⁷ Trupi Gjykses u shpreh se, para se të niste marrja në pyetje, do të përpiquej të njoftonte palët rreth materialit nga sfera publike ose materialit të nxjerrë për Mbrojtjen në përputhje me rregullën 102(3) (“Urdhri për Materialet sipas Rregullës 102(3)”).⁸
7. Më 5 qershor 2024, sërish në përgjigje të kërkesës së Mbrojtjes, Trupi Gjykses zgjeroi kuadrin e Urdhrit për Materialet sipas Rregullës 102(3), duke bërë të ditur se do të përpiquej t’i njoftonte palët në kohë për çdo material sipas rregullës 103 para marrjes në pyetje nga gjykata (“Urdhri për Materialet sipas Rregullës 103”).⁹
8. Më 13 nëntor 2024, ekipet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) (së bashku, “Mbrojtja”) dorëzuan një kërkesë të përbashkët për

⁴ F01495, Mbrojtja, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelin të Urdhrit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses, 1 maj 2023. Shih gjithashtu F01501, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje F01495, 5 maj 2023; F01503, Mbrojtja e Viktimave, Përgjigje e Mbrojtjes së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelin të Urdhrit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses, 8 maj 2023; F01505, Mbrojtja Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje F01495, 8 maj 2023; F01514, Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes së Viktimave (F01503), 10 maj 2023.

⁵ F01531, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelin të Urdhrit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses (“Vendimi për Leje për Apel”), 17 maj 2023.

⁶ IA028/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, Vendim mbi Apelin e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit kundër Urdhrit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga trupi Gjykses, 4 korrik 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, IA028/F00011/RED).

⁷ Transkripti i seancës, 18 mars 2024, f. 13247, rreshti 22 deri në f. 13248, rreshti 16.

⁸ Transkripti i seancës, 19 mars 2024, f. 13381, rreshti 10 deri në f. 13383, rreshti 6.

⁹ Transkripti i seancës, 5 qershor 2024, f. 16710, rreshti 16 deri në f. 16711, rreshti 3.

Trupin Gjykues që të marrë masa për të mundësuar perceptimin e paanshmërisë së procesit dhe për të shmangur dëmtimin e Mbrojtjes ("Kërkesa").¹⁰

9. Më 25 nëntor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigja").¹¹

10. Më 27 nëntor 2024, Trupi Gjykues dëgjoji parashtrimet nga palët lidhur me kundërshtimin e Mbrojtjes ndaj përdorimit nga Trupi Gjykues të disa materialeve sipas rregullës 102(3) gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit W03873 ("Parashtrimet Shtesë").¹² Po atë ditë, Trupi Gjykues bëri të ditur se në shqyrtimin e kësaj Kërkese¹³ do të merrte parasysh Parashtrimet Shtesë.

11. Më 2 dhjetor 2024, Mbrojtja u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigja").¹⁴

II. PARASHTRIMET

12. Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykues të ndërmarrë hapa për të siguruar perceptimin e paanshmërisë dhe për të kufizuar dëmtimin e Mbrojtjes gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykues.¹⁵ Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykues: (i) të marrë parasysh kundërshtimet e Mbrojtjes; (ii) të veprojë në mënyrë të paanshme; dhe (iii) të bëjë një përpjekje të ndershme për të krijuar perceptimin e paanshmërisë në mënyrën se si ia drejton pyetjet dëshmitarit.¹⁶ Në veçanti,

¹⁰ F02718, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes drejtuar Trupit Gjykues për të Marrë Masa me qëllim Sigurimin e Perceptimit të Paanshmërisë së Procesit dhe Shmangien e Dëmit ndaj Mbrojtjes*, 13 nëntor 2024.

¹¹ F02747, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes F02718*, 25 nëntor 2024.

¹² Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22779, rreshti 3 deri në f. 22790, rreshti 8.

¹³ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22803, rreshtat 10-14.

¹⁴ F02756, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes F02718*, 2 dhjetor 2024.

¹⁵ Kërkesa, para. 1, 19.

¹⁶ Kërkesa, para. 24.

Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykses që: (i) të bëjë pyetje që vënë në provë argumentet e ZPS-së; (ii) të kufizojë praktikën e sugjerimit të përgjigjeve dëshmitarëve; dhe (iii) të shmangë “përdorimin e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykses për të nxjerrë prova kundër të akuzuarve që shkojnë përtej pyetjeve të vetë Prokurorisë”.¹⁷ Mbrojtja argumenton se mënyra se si i bën pyetjet Trupi Gjykses gjatë këtij gjykimi: (i) ka krijuar perceptimin e njëanshmërisë;¹⁸ dhe (ii) ka shkelur të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe për një trup gjykses të pavarur dhe të paanshëm.¹⁹

13. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të rrëzohet.²⁰ Ajo parashtro se Kërkesa synon të pengojë funksionin e Trupit Gjykses për zbulimin e së vërtetës dhe të kufizojë në mënyrë të palejuar të drejtën e gjykatësve për të marrë në pyetje dëshmitarët.²¹ ZPS-ja argumenton se pretendimet e Mbrojtjes për njëanshmëri dhe/ose dëmtim janë proceduralisht të gabuara dhe të pafaktuara.²² ZPS-ja parashtro se masa e kërkuar nga Mbrojtja është e paqartë, e pajustificuar dhe duhet të hidhet poshtë menjëherë.²³

14. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Kërkesa është e bazuar mirë.²⁴ Mbrojtja përsërit se marrja në pyetje nga Trupi Gjykses: (i) ka krijuar perceptimin e anshmërisë dhe (ii) ka shkelur të drejtën e të akuzuarve për gjykim të drejtë.²⁵ Mbrojtja parashtro se ZPS-ja nuk e kundërshton faktin që, një vëzhguesi të arsyeshëm, marrja në pyetje e dëshmitarëve nga Trupi Gjykses deri tani, do t’i dukej se: (i) nuk ka vënë në provë argumentet e Prokurorisë dhe (ii) ka vënë në provë kryesisht

¹⁷ Kërkesa, para. 24.

¹⁸ Kërkesa, para. 21, 23. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 19-20.

¹⁹ Kërkesa, para. 23.

²⁰ Përgjigja, para. 1, 14.

²¹ Përgjigja, para. 2, 4-5. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 12-13.

²² Përgjigja, para. 3. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 7-9.

²³ Përgjigja, para. 3, 10-13.

²⁴ Kundërpërgjigja, para. 1.

²⁵ Kundërpërgjigja, para. 4. *Shih edhe* Transkriptin e seancës, 27 nëntor 2024, f. 22780, rreshtat 20-22, f. 22781, rreshtat 15-25, f. 22782, rreshti 1.

prezumimin e pafajësisë së të akuzuarve. Sipas parashtrimeve të Mbrojtjes, këto dy “fakte të pakontestuar”, së bashku me provat empirike të marra nga raportet mbi kohëzgjatjen, përligjin masën e kërkuar.²⁶

15. Në Parashtrimet Shtesë,²⁷ Mbrojtja e Veselit argumenton se marrja e njoftimit, menjëherë para marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykses, se ky i fundit synon të përdorë materiale të nxjerra sipas rregullave 102(3) dhe 103: (i) nuk përbën njoftim adekuat dhe (ii) është e padrejtë dhe ka efekt dëmtues.²⁸ Mbrojtja e Thaçit mbështeti parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit, duke theksuar se një praktikë e tillë dëmton Mbrojtjen për shkak të mungesës së njoftimit adekuat.²⁹ Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Krasniqit iu bashkuan këtyre parashtrimeve.³⁰ ZPS-ja përgjigjet se ka nxjerrë menjëherë për Mbrojtjen e Thaçit dhe Mbrojtjen e Selimit materialet që nuk ishin shpërndarë më parë.³¹ ZPS-ja argumenton se: (i) kërkesa e Mbrojtjes për të shtyrë marrjen në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykses lidhur me këto materiale është e parakohshme; dhe se (ii) nëse lind nevoja, Mbrojtja mund të kërkojë kohë shtesë, pas marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykses.³²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PAANSHMËRIA

16. Në përputhje me nenin 21 të Ligjit, të akuzuarit kanë të drejtë, ndër të tjera, që: (i) të kenë një gjykim të drejtë dhe publik në shqyrtimin e akuzave kundër tyre;

²⁶ Kundërpërgjigja, para. 2.

²⁷ *Shih më lart* para. 10.

²⁸ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22780, rreshtat 20-22, f. 22781, rreshtat 15-25, f. 22782, rreshti 1, f. 22783, rreshtat 1-7, f. 22784, rreshtat 10-20.

²⁹ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22785, rreshtat 1-25, f. 22786, rreshtat 2-6.

³⁰ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22789, rreshti 23 deri në f. 22790, rreshtat 7-8.

³¹ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22788, rreshtat 14-17.

³² Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22788, rreshtat 17-23. *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 27 nëntor 2024, f. 22786, rreshtat 10-17.

(ii) të kenë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre;
(iii) të marrin në pyetje, ose të bëjnë të mundur marrjen në pyetje të dëshmitarëve kundër tyre dhe të sigurojnë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në mbështetje të tyre, në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tyre.

17. Në përputhje me nenin 40(2) të Ligjit, Trupi Gjykses siguron që gjykimi të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procesi të kryhet në pajtim me Rregulloren, në respekt të plotë të të drejtave të të akuzuarve. Në bazë të kësaj dispozite, Trupi Gjykses mund të japë udhëzime për zhvillimin e proceseve gjyqësore të drejta dhe të paanshme.

18. Në përputhje me nenin 3(2) të Ligjit dhe nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdo person ka të drejtë të gjykohe drejtësisht dhe publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, nga një trup gjykses i pavarur dhe i paanshëm, i themeluar me ligj.

19. Në përputhje me nenin 4(1) të Kodit të Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e emëruar në listën e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK"), gjykatësit ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe sigurojnë perceptimin e paanshmërisë.³³

20. Rregulla 20 përcakton kushtet dhe rrethanat në të cilat gjykatësit duhet të vetëtërhiqen ose të hiqen, si dhe procedurën përmes së cilës mund të kërkohet një masë e tillë.

21. Siç përcaktohet në jurisprudencën përkatëse, për çdo gjykatës merret si i mirëqenë një prezumim i fortë për paanshmëri, i cili nuk mund të hidhet poshtë aq lehtë.³⁴ Gjykatësit jo vetëm që duhet të jenë të paanshëm si persona, por duhet

³³ KSC-BD-01/Rev1/2023, *Kodi i Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës* (miratuar më 14 mars 2017 dhe ndryshuar më 24 mars 2023), neni 4(1).

³⁴ KSC-BC-2020-07, F00272, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, *Vendim mbi Kërkesën për Vetëtërheqjen ose Heqjen e Gjykatësve* ("Vendimi për Heqjen e Gjykatësve në Çështjen 07"), 6 gusht 2021, para. 31-32

gjithashtu që rrethanat e çështjes objektivisht nuk duhet të krijojnë perceptimin e anësisë së gjykimit.³⁵

22. Perceptimi i papranueshëm i anshmërisë ekziston në ato raste kur rrethanat do të çonin një vëzhgues të arsyeshëm dhe të informuar si duhet, të dallojë logjikisht se ka anshmëri.³⁶ Personi i arsyeshëm duhet të jetë person i informuar, në dijeni të të gjitha rrethanave relevante, përfshirë traditat e integritetit dhe paanshmërisë që janë pjesë e kontekstit të çështjes, si dhe i vetëdijshëm për faktin se paanshmëria është një nga detyrimet që gjykatësit betohen ta respektojnë.³⁷

23. Kur kërkohet vetëtërheqja ose heqja e një gjykatësi për shkak të mungesës së paanshmërisë dhe/ose mosperceptimit të paanshmërisë, i takon palës që bën kërkesën të paraqesë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se gjykatësi nuk është i paanshëm dhe ka një standard të lartë për përmbysjen e prezumimit të paanshmërisë.³⁸ Ajo palë duhet të demonstrojë “një perceptim të arsyeshëm për

dhe referencat në të. Shih gjithashtu International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia (“ICTY”), *Prosecutor v. Hadžihasanović et al.*, IT-01-47-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Hadžihasanović Appeal Judgement”), 22 April 2008, para. 78; *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Furundžija Appeal Judgment”), 21 July 2000, para. 197; *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Galić Appeal Judgement”), 30 November 2006, para. 41; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Čelebići Appeal Judgement”), 20 February 2001, para. 707; International Criminal Tribunal for Rwanda (“ICTR”), *Prosecutor v. Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Nahimana et al. Appeal Judgement”), 28 November 2007, para. 48; *Rutaganda v. Prosecutor*, ICTR-96-3-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Rutaganda Appeal Judgement”), 26 May 2003, para. 42; *Prosecutor v. Akayesu*, ICTR-96-4-A, Appeals Chamber, [Judgement](#) (“Akayesu Appeal Judgement”), 1 June 2001, para. 91.

³⁵ ICTY, [Hadžihasanović Appeal Judgement](#), para. 78. Shih gjithashtu [Galić Appeal Judgement](#), para. 38; [Furundžija Appeal Judgement](#), para. 189; [Nahimana et al. Appeal Judgement](#), para. 49; [Rutaganda Appeal Judgement](#), para. 39; [Akayesu Appeal Judgement](#), para. 203.

³⁶ Vendimi për Heqjen e Gjykatësve në Çështjen 07, para. 31. Shih gjithashtu ICTY, [Hadžihasanović Appeal Judgement](#), para. 78; [Galić Appeal Judgement](#), para. 39; [Furundžija Appeal Judgement](#), para. 189; [Nahimana et al. Appeal Judgement](#), paras 49-50; [Rutaganda Appeal Judgement](#), para. 39; [Akayesu Appeal Judgement](#), para. 203.

³⁷ [Rutaganda Appeal Judgement](#), para. 40.

³⁸ ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74, Presidency, [Decision of the President on Jadranko Prlić's Motion to Disqualify Judge Árpád Prandler](#) (“Prlić Decision”), 4 October 2010, para 7 and references cited. Shih gjithashtu *Prosecutor v. Milan Lukić and Sredoje Lukić*, IT-98-32/1, Presidency, [Decision on Motion for Disqualification](#) (“Lukić Decision”), 12 January 2009, para 3; *Prosecutor v. Vidoje Blagojević*, IT-02-60-R, Presidency, [Decision on Motion for Disqualification](#) (“Blagojević Decision”), 2 July 2008,

anshmëri për shkak të paragjykitimit”, të cilin duhet "ta vërtetojë qartësisht".³⁹ Ky standard i lartë kërkohet, sepse “vetëtërheqja e gjykatësve për shkak të pretendimeve të pabazuara dhe të pambështetura me prova për perceptim të anshmërisë është po aq kërcënim për interesat e administrimit të paanshëm dhe të drejtë të drejtësisë sa edhe perceptimi real i anshmërisë”.⁴⁰

24. Kur paraqiten kërkesa të tilla, pala që bën kërkesën duhet të shpjegojë konkretisht argumentet ku mbështet pretendimin për anshmëri; Trupi Gjykses nuk mund të shqyrtojë pretendime të përgjithshme ose abstrakte, të cilat nuk janë as të faktuara dhe as të hollësishme për të përmbysur prezumimin e paanshmërisë së gjykatësit.⁴¹

25. Për të vërtetuar ekzistencën e paanshmërisë gjyqësore, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”) zbaton dy standarde: (i) *standardin subjektiv*, i cili nënkupton që gjykatësi të mos ketë bindjen e vet apo interes në një çështje specifike; dhe (ii) *standardin objektiv*, i cili konsiston në konstatimin nëse trupi gjykses ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim lidhur me paanshmërinë e tij, ose nëse ekzistojnë fakte të verifikueshme që mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij.⁴² Vendimtare është nëse frika [e

para 3; *Prosecutor v. Vojislav Šešelj*, IT-03-67-PT, Presidency, [Decision on Motion for Disqualification](#) (“Šešelj Decision”), 16 February 2007, para 5; [Furundžija Appeal Judgment](#), 21 July 2000, paras 196-197; *In the Case against Florence Hartmann*, IT-02-54-R77-5, Trial Chamber, [Report of Decision on Defence Motion for Disqualification of Two Members of the Trial Chamber and Senior Legal Officer](#), 27 March 2009, para 25.

³⁹ [Lukić Decision](#), para 3; [Blagojević Decision](#), para 3; [Furundžija Appeal Judgment](#), para 197; [Čelebići Appeal Judgment](#), para 707; [Prlić Decision](#), para 7. *Shih gjithashtu* Special Tribunal for Lebanon (“STL”), *In the Matter of El Sayed*, CH/PRES/2010/09, Presidency, [Decision on Mr El Sayed’s Motion for the Disqualification of Judge Chamseddine from the Appeals Chamber Pursuant to Rule 25](#), 5 November 2010, para. 17.

⁴⁰ [Lukić Decision](#), para 3; [Blagojević Decision](#), para 3; [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 707; [Prlić Decision](#), para. 7.

⁴¹ [Rutaganda Appeal Judgment](#), para. 43; [Akayesu Appeal Judgment](#), para. 91.

⁴² ECtHR, *Kyprianou v. Cyprus*, no. 73797/01, Grand Chamber, [Judgment](#) (“Kyprianou Judgment”), 15 December 2005, paras 118-119; *Morice v. France*, no. 29369/10, Grand Chamber, [Judgment](#) (“Morice Judgment”), 23 April 2015, para. 73; *Hauschildt v. Denmark*, no. 10486/83, Grand Chamber, [Judgment](#), 24 May 1989, para. 46; *Revtyuk v. Russia*, no. 31796/10, Grand Chamber, [Judgment](#), 9 April 2018, para. 22.

anshmërisë] mund të konsiderohet e përligjur objektivisht.⁴³ Perceptimi mund të ketë njëfarë rëndësie.⁴⁴

B. KUADRI I MARRJES NË PYETJE NGA TRUPI GJYKUES

26. Lidhur me marrjen e dëshmitarëve në pyetje nga Trupi Gjykses, rregulla 127(3) përcakton se gjykatësi “mund t’i bëjë pyetje dëshmitarit në çdo fazë”.

27. Në këtë aspekt, Paneli i Apelit ka mbajtur më parë qëndrimin se rregulla 127(3), e cila ofron bazën ligjore për kompetencën e Trupit Gjykses për të marrë në pyetje dëshmitarët,⁴⁵ nuk vendos asnjë kufizim lidhur me lëndën e pyetjeve të Trupit Gjykses drejtuar dëshmitarëve.⁴⁶ Përkundrazi, Trupi Gjykses gëzon një kompetencë të gjerë diskrecionale për t’u parashtruar dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme për sqarimin e dëshmisë së tyre ose për zbulimin e së vërtetës.⁴⁷ Në veçanti, Paneli i Apelit konstatoi se pyetjet drejtuar një dëshmitari “mund të përfshijnë fakte dhe pika që nuk janë ngritur nga palët, si dhe fakte të ndryshme nga ato të përshkruara në akuza, me kusht që këto pyetje të mos krijojnë përshtypjen e anësisë, pësim dëmi apo të shkelin të drejtat e të akuzuarve”.⁴⁸

28. Së fundi, gjatë përcaktimit të procedurave për paraqitjen e provave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve,⁴⁹ ky Trup Gjykses ka përcaktuar se, kur dalin aspekte tërësisht të reja si rrjedhojë e pyetjeve për dëshmitarin nga Trupi Gjykses, pas marrjes në pyetje nga pala jothirrëse dhe pyetjeve shtesë nga pala thirrëse, çdo

⁴³ [Morice Judgment](#), para. 76.

⁴⁴ [Kyprianou Judgment](#), para. 118; [Morice Judgment](#), para. 78.

⁴⁵ Vendimi i Apelit, para. 29.

⁴⁶ Vendimi i Apelit, para. 32 dhe referencat e cituara në të.

⁴⁷ Vendimi i Apelit, para. 32 dhe referencat e cituara në të.

⁴⁸ Vendimi i Apelit, para. 32 dhe referencat e cituara në të.

⁴⁹ Urdhri mbi Zhvillimin e Gjyqimit, Pjesa F – Marrja në pyetje e dëshmitarëve, f. 26-28.

palë mund të bëjë kërkesë me gojë për leje për të marrë në pyetje dëshmitarin më tej lidhur me aspektet e reja.⁵⁰

IV. DISKUTIM

A. LLOJI I KËRKESËS

29. Mbrojtja parashtroi se, duke pasur parasysh përparimin e konsiderueshëm të procesit, situata ka ndryshuar që nga momenti kur Paneli i Gjykatës së Apelit shpalli Vendimin e Apelit.⁵¹ Mbrojtja argumenton se masa e re e kërkuar në Kërkesë përliqet nga situata e ndryshuar që ka lindur pas Vendimit të Apelit.⁵²

30. ZPS-ja argumenton se Kërkesa përpiqet të rihapë debat juridik mbi një vendim të apelit pa paraqitur argumente të reja ligjore apo trajtuar standardin ligjor për rishqyrtim.⁵³

31. Mbrojtja kundërshton pretendimin e ZPS-së, sipas së cilës Mbrojtja po rihap debatin mbi Vendimin e Apelit, pasi Paneli i Gjykatës së Apelit ka përcaktuar qartë një kufi në lidhje me marrjen në pyetje nga Trupi Gjykses, i cili është tejkaluar nga Trupi Gjykses që prej shpalljes së vendimit nga Paneli i Gjykatës së Apelit.⁵⁴

32. Trupi Gjykses pranon se disa nga argumentet e parashtruara në Kërkesë janë shumë të ngjashme, ose përsëritëse, të argumenteve që Mbrojtja paraqiti në parashtrimin që çoi në Vendimin e Apelit.⁵⁵ Megjithatë, Trupi Gjykses është i mendimit se pika juridike thelbësore në këtë Kërkesë – pra, nëse mënyra e pyetjeve të Trupit Gjykses për dëshmitarët krijon perceptimin e anshmërisë – është e

⁵⁰ Urdhri për Zhvillimin e Gjykimit, para. 112.

⁵¹ Kërkesa, para. 22.

⁵² Kërkesa, para. 22.

⁵³ Përgjigja, para. 2, 4, 6.

⁵⁴ Kundërpërgjigja, para. 3.

⁵⁵ *Shih p.sh.* Vendimin e Apelit, para. 23-24, 27, 30, 36-39, 44, poshtëshënimet 55, 57, 68, 70, 73, 88-97, 114-117 dhe referencat e cituara në to.

ndryshme nga ajo që u shqyrtua në Vendimin e Apelit – pra, nëse kuadri i marrjes në pyetje shkoi përtej asaj që lejohet me Ligj dhe Rregullore.⁵⁶ Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk bindet nga argumenti i ZPS-së se Mbrojtja kërkon vetëm të rihapë debatin mbi Vendimin e Apelit pa paraqitur argumente të reja dhe vlerëson se kjo Kërkesë nuk përbën kërkesë për rishqyrtim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të shqyrtojë Kërkesën në themel, pa iu referuar kriterit ligjor për rishqyrtimin.

33. Megjithatë, nga Trupi Gjykses nuk mund të pritët të shqyrtojë pretendime të përgjithshme ose abstrakte, të cilat nuk janë as të faktuara, as të detajuara për të përmbysur prezumimin e paanshmërisë. Në këtë drejtim, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja nuk po kundërshton asnjë vendim të dhënë nga Trupi Gjykses, as nuk ka identifikuar ndonjë pikë konkrete për të cilën pretendon se çoi në shqetësimin për paanshmërinë, që ajo ngriti në parashtrime. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë asnjë pikë që nuk është paraqitur si duhet përpara tij.⁵⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton faktin se Mbrojtja po kërkon mjet juridik që nuk parashikohet shprehimisht nga Rregullorja dhe nuk po shfrytëzon mjetin e parashikuar shprehimisht nga po e njëjta Rregullore.⁵⁸

B. MARRJA NË PYETJE NGA TRUPI GJYKSES

34. Mbrojtja parashtron se koha “shumë e konsiderueshme” e përdorur për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga Trupi Gjykses⁵⁹ po ndikon në zhvillimin e shpejtë të procesit.⁶⁰ Mbrojtja argumenton se çdo mangësi në prova duhet të trajtohet nga palët përmes pyetjeve shtesë, ndërsa pyetjet e bëra nga Trupi Gjykses

⁵⁶ Vendimi për Leje për Apel, para. 8(2) dhe (4), 23-31, 35-42.

⁵⁷ Shih [Furundžija Appeal Judgement](#), para. 173-174. Shih gjithashtu [Galić Appeal Judgement](#), para. 34; [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 651-709.

⁵⁸ Shih rregullën 20.

⁵⁹ Kërkesa, paragrafi 19, tregon “71 orë, 36 minuta dhe 34 sekonda deri më 11 nëntor 2024”; “13 ditë kohë gjyqi”; “tejkalon kohën e përdorur nga tre prej katër ekipeve të Mbrojtjes”.

⁶⁰ Kërkesa, para. 19.

duhet të përdoren zakonisht për të sqaruar aspekte të provave dhe nuk duhet të marrin më shumë kohë sesa pyetjet e drejtuara nga palët.⁶¹ Mbrojtja më tej argumenton se “pabarazia e skajshme” mes kohës që i duhet Mbrojtjes për pyetjet shitesë, *pas* marrjes së dëshmitarit në pyetje nga Trupi Gjykses, krahasuar me kohën që i duhet ZPS-së për pyetjet e veta shitesë⁶² tregon se: (i) ZPS-ja nuk i konsideron pyetjet e gjykatësve si sfiduese për argumentet e Prokurorisë; (ii) Mbrojtja i percepton pyetjet e gjykatësve si cenim të prezumimit të pafajësisë së të akuzuarve; dhe (iii) një vëzhgues i arsyeshëm nuk do të mund ta perceptonte si të paanshme marrjen në pyetje nga gjykatësit.⁶³ Mbrojtja parashtrohet se kjo bie ndesh me: (i) të drejtën e të akuzuarve për një trup gjykses të pavarur dhe të paanshëm; dhe (ii) detyrimin etik të Trupit Gjykses për të qenë realisht i paanshëm, por edhe për t’u perceptuar si i paanshëm kur i bën pyetje dëshmitarit.⁶⁴

35. ZPS-ja përgjigjet se i vetmi argument që Mbrojtja paraqet në mbështetje të pretendimit të saj për perceptim të anshmërisë është koha e përdorur nga Trupi Gjykses për marrjen në pyetje të dëshmitarëve krahasuar me kohën e përdorur në pas nga palët për pyetjet shitesë, pa bërë asnjë përpjekje për të vlerësuar nëse pyetjet konkrete të bëra nga Trupi Gjykses plotësojnë standardin ligjor të anshmërisë gjyqësore.⁶⁵ ZPS-ja argumenton se interpretimi që Mbrojtja i bën kohës së përdorur nga gjykatësit për marrjen në pyetje të dëshmitarëve është çorientues, i pakuptimtë dhe i pamjaftueshëm për të ngritur një pretendim për anshmëri të Trupit Gjykses, pa marrë parasysh rrethanat specifike të secilit dëshmitar dhe

⁶¹ Kërkesa, para. 19.

⁶² Kërkesa, para. 20 thotë “Deri më 11 nëntor 2024, Mbrojtja ka kërkuar gjithsej 31 orë e 23 minuta për pyetje shitesë pas pyetjeve të Trupit Gjykses; Prokuroria ka përdorur 12 minuta”, duke theksuar se Mbrojtja “ka pasur nevojë të përdorë mbi 100 herë më shumë kohë për pyetje shitesë sesa Prokuroria”.

⁶³ Kërkesa, para. 20-21, 23.

⁶⁴ Kërkesa, para. 21.

⁶⁵ Përgjigjja, para. 7.

pyetjet e bëra.⁶⁶ ZPS-ja gjithashtu argumenton se Mbrojtja nuk pranon faktin që pjesë e pyetjeve shtesë të saj ishin përsëritëse ose jashtë kuadrit të pyetjeve nga Trupi Gjykses, gjë që e detyroi këtë të fundit të merrte masa korrigjuese.⁶⁷

36. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Paneli i Gjykatës së Apelit ka mbajtur shprehimisht qëndrimin se pyetjet nga gjykatësit nuk duhet “të krijojnë përshtypjen e anësisë, pësim dëmi apo të shkelin të drejtat e të akuzuarve”.⁶⁸ Sipas parashtrimeve të Mbrojtjes, Trupi Gjykses e shkeli këtë kufi.⁶⁹ Mbrojtja kundërshton pretendimin e ZPS-së se Mbrojtja synon të pengojë funksionin e Trupit Gjykses për zbulimin e së vërtetës. Përkundrazi, Mbrojtja argumenton se funksioni i Trupit Gjykses për zbulimin e së vërtetës kufizohet nga Vendimi i Apelit dhe nga neni 4 i Kodit të Etikës Gjyqësore.⁷⁰ Mbrojtja kundërshton gjithashtu pretendimin e ZPS-së se diferenca në kohën e përdorur nga palët për pyetjet shtesë vjen si rezultat i pyetjeve “përsëritëse” dhe “jashtë kuadrit të pyetjeve të gjykatësve” nga ana e Mbrojtjes.⁷¹ Së fundi, Mbrojtja parashton se vetë Trupi Gjykses bëri pyetje sugjeruese, pavarësisht nga urdhri për Mbrojtjen për shmangien e pyetjeve të tilla dhe deklaratën e Kryetares se pyetje të tilla janë shprehimisht të ndaluara.⁷²

37. Lidhur me kohëzgjatjen e përgjithshme të pyetjeve nga Trupi Gjykses, Trupi Gjykses vëren së pari se Rregullorja nuk përcakton asnjë kufizim për kohën që Trupi Gjykses mund të shpenzojë duke u bërë pyetje dëshmitarëve. Trupi Gjykses thekson se në shumë sisteme juridike, pjesa më e madhe e pyetjeve bëhet nga gjykatësit. Kufizimet e vetme të zbatueshme për pyetjet janë po ato që zbatohen edhe për palët dhe pjesëmarrësit: relevanca; shmangia e përsëritjeve të

⁶⁶ Përgjigja, para. 8-9.

⁶⁷ Përgjigja, para. 8.

⁶⁸ Kundërpërgjigja, para. 3.

⁶⁹ Kundërpërgjigja, para. 3.

⁷⁰ Kundërpërgjigja, para. 3-4.

⁷¹ Kundërpërgjigja, para. 5.

⁷² Kundërpërgjigja, para. 6.

panevojshme; dhe respektimi i të drejtës themelore të të akuzuarve për gjykim pa vonesa të panevojshme. Së dyti, Trupi Gjykses vëren se kohëzgjatja e pyetjeve duhet parë në kontekstin e tërësisë së dëshmive të dëshmitarëve.⁷³ Në rrethanat aktuale, Mbrojtja mbështetet thjesht në kohëzgjatjen e gjithsejtë të përdorur nga Trupi Gjykses për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, pa marrë parasysh llojin apo përmbajtjen e pyetjeve dhe/ose dëshmitarin të cilit iu drejtuan. Për shembull, Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses mori në pyetje nëntë dëshmitarë për më shumë se dy orë.⁷⁴ Mbrojtja nuk ka identifikuar as edhe një pyetje të vetme të drejtuar nga Trupi Gjykses ndonjërit prej këtyre dëshmitarëve që të ishte jorelevante, apo që të mos i ketë shërbyer zbulimit të së vërtetës. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se këta dëshmitarë ishin që të gjithë kompleksë, që çoi në një kohë të konsiderueshme pyetjesh nga pala thirrëse dhe/ose nga pala jothirrëse,⁷⁵ dhe shpesh pyetje nga më shumë se një anëtar i Trupit Gjykses. Si pasojë, kohëzgjatja e gjithsejtë për pyetje nga Trupi Gjykses ishte në përpjesëtim me rëndësinë dhe relevancën e këtyre dëshmitarëve, si dhe me përgjegjësitë e Trupit Gjykses për zbulimin e së vërtetës. Këto pyetje nuk do ta çonin një vëzhgues të arsyeshëm, të informuar siç duhet, në një perceptim të arsyeshëm për anshmëri. Parashtrimet e Mbrojtjes ngrenë thjesht një rrezik spekulativ ose hipotetik për dëmtim, i cili është i pafaktuar dhe nuk merr parasysh faktin se, në sistemin në fuqi, detyra e gjykatësit është zbulimi i së vërtetës.⁷⁶ Sqarimi i dëshmisë së një dëshmitari

⁷³ Vendimi i Apelit, para. 52.

⁷⁴ Kërkesa, para. 22.

⁷⁵ *Shih* Raportin Periodik mbi Kohëzgjatjen, 11 nëntor 2024, konfidencial; W04746 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 16 orë 7 minuta), W04769 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 7 orë 57 minuta), W04765 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 8 orë 38 minuta), W01493 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 6 orë 30 minuta), W04147 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 12 orë 16 minuta), W04739 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 9 orë 19 minuta), W04744 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 8 orë 49 minuta), W04752 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 31 orë 25 minuta), W04737 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 8 orë 42 minuta), W04240 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 7 orë), W04758 (Kohëzgjatja e gjithsejtë e pyetjeve nga palët 8 orë 22 minuta).

⁷⁶ Vendimi i Apelit, para. 51.

dhe/ose nxjerrja e provave që mund të ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit i mundëson Trupit Gjykses të bazojë konstatimet e tij mbi të gjitha provat përkatëse, duke avancuar kështu procesin e zbulimit të së vërtetës. Më tej, Trupi Gjykses vëren se parashtrimi i pyetjeve për dëshmitarët e ZPS-së pas dëshmisë së tyre kryesore kontribuon në një kryerje më të shpejtë të procesit sesa rikthimi i dëshmitarëve në një moment të mëvonshëm⁷⁷ ose përdorimi nga ana e Trupit Gjykses i mundësisë për të paraqitur prova sipas rregullës 132. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është bindur që pyetjet e tij zgjatën në mënyrë të panevojshme procesin apo shkelën të drejtat e të akuzuarve.

38. Lidhur me “pabarazinë e skajshme” mes kohës së kërkuar nga Mbrojtja dhe kohës së kërkuar nga ZPS-ja për pyetjet shtesë *pas* pyetjeve nga Trupi Gjykses,⁷⁸ ky i fundit thekson se i takon secilës palë të vendosë nëse dëshiron të bëjë pyetje shtesë dhe kur dëshiron t’i bëjë. Fakti që, pas marrjes së dëshmitarit në pyetje nga Trupi Gjykses, Mbrojtja zgjedh ndonjëherë t’i bëjë dëshmitarit pyetje të shumta është e drejta e saj, po aq sa është edhe e drejta e ZPS-së të mos bëjë të njëjtën gjë. Këto janë zgjedhje që janë plotësisht pjesë e diskrecionit të mbrojtësve, të cilin Trupi Gjykses e ka respektuar. Mënyra se si duhet pyetur dëshmitari varet domosdoshmërisht nga rrethanat e dëshmisë së tij.⁷⁹ Edhe një herë, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja nuk ka identifikuar asnjë pyetje të bërë nga ndonjë gjykatës që ajo pretendon se vonoi mënyrë të panevojshme ose të papërligjur procesin. Rrjedhimisht, Mbrojtja nuk ka arritur të tregojë se marrja në pyetje e dëshmitarëve nga ana e Trupit Gjykses, dhe “pabarazia e skajshme” që rezulton në kohën e pyetjeve shtesë të palëve, do ta çonte një vëzhgues të arsyeshëm, të informuar siç

⁷⁷ Vendimi i Apelit, para. 51.

⁷⁸ Kërkesa, para. 20 thotë “Deri më 11 nëntor 2024, Mbrojtja, në tërësi, ka kërkuar 31 orë e 23 minuta për pyetje shtesë pas pyetjeve nga Trupit Gjykses; ndërkohë që Prokuroria ka përdorur vetëm 12 minuta, duke theksuar se Mbrojtja “ka pasur kështu nevojë të përdorë mbi 100 herë më shumë kohë për pyetje shtesë sesa Prokuroria”.

⁷⁹ Vendimi i Apelit, para. 52.

duhet, në një perceptim të arsyeshëm për anshmëri.

39. Lidhur me argumentet e Mbrojtjes se marrja në pyetje e dëshmitarëve nga Trupi Gjykses nuk ka vënë në provë argumentet e Prokurorisë,⁸⁰ Trupi Gjykses vë në dukje se Paneli i Gjykatës së Apelit ka konstatuar më parë se rregulla 127(3), e cila përcakton bazën ligjore për kompetencën e Trupit Gjykses për të marrë në pyetje dëshmitarët,⁸¹ nuk vendos asnjë kufizim lidhur me lëndën e pyetjeve të Trupit Gjykses drejtuar dëshmitarëve.⁸² Përkundrazi, Trupi Gjykses gëzon një kompetencë të gjerë diskrecionale për t'u parashtuar dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme për sqarimin e dëshmive të tyre ose për zbulimin e së vërtetës.⁸³ Pyetjet e Trupit Gjykses në funksion të zbulimit të së vërtetës mund të çojnë si në prova inkriminuese, ashtu edhe në prova shfajësuese, ose në aspekte sqaruese që lidhen me besueshmërinë e një dëshmitari. Pyetjet nuk bëhen për të nxjerrë prova inkriminuese ose shfajësuese, por për të nxjerrë prova që Trupi Gjykses i konsideron relevante dhe të nevojshme për përmbushjen e funksionit të tij për zbulimin e së vërtetës. Mbrojtja nuk ka paraqitur asnjë referencë specifike në dokumentacion ku pretendohet se Trupi Gjykses ka keqpërdorur kompetencën e vet të gjerë diskrecionale për t'u bërë dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme për sqarimin e dëshmive të tyre ose për zbulimin e së vërtetës.

40. Lidhur me kërkesën e Mbrojtjes që Trupi Gjykses të shmangë sugjerimin e dëshmisë për dëshmitarët përmes pyetjeve sugjeruese, Trupi Gjykses rikujton se rregulla 127(3) i jep Trupit Gjykses kompetencë të gjerë diskrecionale për t'u bërë dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme. Kjo rregull nuk rregullon mënyrën se si duhet të bëhen pyetjet. Trupi Gjykses më tej rikujton qëndrimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, sipas të cilit mënyra se si duhet pyetur një dëshmitar

⁸⁰ Kërkesa, para. 21, 23.

⁸¹ Vendimi i Apelit, para. 29.

⁸² Vendimi i Apelit, para. 32 dhe referencat e cituara në të.

⁸³ Vendimi i Apelit, para. 32 dhe referencat e cituara në të.

varet nga rrethanat e dëshmisë së atij dëshmitari.⁸⁴ Për shembullin specifik që citon Mbrojtja,⁸⁵ Trupi Gjykses thekson se këtij dëshmitari iu desh të kujtohej në mënyrë të përsëritur që t'u përgjigjej pyetjeve të drejtuara nga Trupi Gjykses.⁸⁶ Për këtë arsye, Trupi Gjykses përdori pyetje sugjeruese për ta mbajtur dëshmitarin të përqendruar në pyetjet që iu bënë dhe për të mundësuar që dëshmitari të përgjigjej, siç kërkohet dhe pritët. Mospërgjigjja e një dëshmitari ndaj pyetjeve, qofshin ato pyetje nga gjykatësit apo nga palët, mund të jetë relevante për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit nga Trupi Gjykses. Në këto rrethana, Mbrojtja nuk ka arritur të dëshmojë se mënyra e pyetjes së dëshmitarit nga ana e Trupit Gjykses do ta çonte një vëzhgues të arsyeshëm, të informuar siç duhet, në një perceptim të arsyeshëm për anshmëri.

41. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se marrja prej tij në pyetje e dëshmitarit nuk shkeli të drejtat e të akuzuarve dhe nuk çoi një vëzhgues të arsyeshëm, të informuar siç duhet, në një perceptim të arsyeshëm për anshmëri. Gjithashtu, nuk është vërtetuar që marrja në pyetje nga Trupi Gjykses të ketë ndikuar në mënyrë të papërshtatshme apo të paarsyeshme në të drejtën për një gjykim pa vonesa të papërligjura.

C. PËRDORIMI I MATERIALEVE SIPAS RREGULLËS 102(3) DHE 103 GJATË MARRJES NË PYETJE TË DËSHMITARËVE NGA TRUPI GJYKSES

42. Mbrojtja argumenton se mbështetja e Trupit Gjykses në materiale sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103, të cilat nuk kishin qenë pjesë e radhës së paraqitjes së materialeve të palëve, dhe që shpesh lidhen me tema që nuk janë

⁸⁴ Vendimi i Apelit, para. 52.

⁸⁵ Kundërpërgjigjja, poshtëshënimi 13.

⁸⁶ *Shih p.sh.* Transkriptin e seancës, 22 shkurt 2024, f. 12883, rreshtat 13-14, f. 12883, rreshtat 21-23, f. 12884, rreshtat 14-16, f. 12886, rreshtat 19-21, f. 12887, rreshtat 10-12, f. 12888, rreshtat 9-10, f. 12890, rreshtat 14-16, f. 12895, rreshtat 9-13.

ngritur nga palët dhe/ose dalin jashtë kuadrit të Aktakuzës⁸⁷ dhe Dosjes Paraprake të ZPS-së⁸⁸, krijon përshtypjen sikur Trupi Gjykses po procedon një çështje më vete.⁸⁹ Mbrojtja argumenton se njoftimi i vonuar ose mungesa e njoftimit për materialet që Trupi Gjykses synon të përdorë, dëmton Mbrojtjes, sepse ajo nuk ka kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur.⁹⁰ Mbrojtja më tej argumenton se dëmi ndaj saj bëhet edhe më i madh kur gjykatësit mbështeten në materiale sipas rregullës 102(3), disa prej të cilave përmbajnë deri në njëqind faqe, të cilat nuk janë nxjerrë për të gjitha ekipet e Mbrojtjes.⁹¹ Në Parashtrimet Shtesë, Mbrojtja kundërshton përdorimin nga Trupi Gjykses të dokumenteve të nxjerra për disa nga ekipet e Mbrojtjes sipas rregullave 102(3) dhe 103 gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit.⁹²

43. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja ka marrë njoftim të mjaftueshëm përmes procedurës në përputhje me rregullën 102(3). Në rast se ekipet e ndryshme të Mbrojtjes zgjedhin të mos kërkojnë materiale specifike, kjo ka pasoja.⁹³

44. Lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes se njoftimi për përdorimin e materialeve sipas rregullës 102(3) gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykses u bë me vonesë ose nuk u bë, Trupi Gjykses thekson, së pari, se Rregullorja nuk kërkon marrjen e një mase të caktuar procedurale, përmes së cilës Trupi Gjykses bën njoftimin për materialet e nxjerra sipas rregullës 102(3) dhe 103 që mund të jenë relevante për marrjen në pyetje nga Trupi Gjykses.⁹⁴ Kjo masë u miratua dhe u vendos nga Trupi Gjykses si rezultat i kërkesave të shprehura të Mbrojtjes për

⁸⁷ Shih F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar* ("Aktakuza"), 30 shtator 2022, konfidenciale.

⁸⁸ Shih F01594/A03, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake* ("Dosja Paraprake e ZPS-së"), 9 qershor 2023, konfidenciale.

⁸⁹ Kundërpërgjigjja, para. 7

⁹⁰ Kundërpërgjigjja, para. 9.

⁹¹ Kundërpërgjigjja, para. 10.

⁹² Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22780, rreshti 20 deri në f. 22790, rreshti 8.

⁹³ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, f. 22788, rreshtat 6-13.

⁹⁴ Transkripti i seancës, 19 mars 2024, f. 13381, rreshtat 18-20.

këto materiale dhe me qëllim garantimin e drejtësisë dhe mundësisë së palëve për t'u përgatitur. Tani, Mbrojtja po kundërshton ose po vë në pikëpyetje një masë që ajo vetë e kërkoi dhe që u miratua për të mirën e saj. Së dyti, Trupi Gjykses vëren se urdhrat dhe vendimet e tij për vendosjen e kësaj mase procedurale nuk u kundërshtuan (p.sh. përmes një kërkesë për rishikim) nga Mbrojtja pas hyrjes së tyre në fuqi. Së treti, Trupi Gjykses thekson se, ashtu si palët, edhe Trupi Gjykses është në gjendje të njoftojë për dokumentet që mund të përdorë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve vetëm pasi të ketë dëgjuar pyetjet e drejtuara nga palët (dhe pjesëmarrësit) dhe dëshminë e dëshmitarit. Mbrojtja nuk ka arritur të shpjegojë se si mund të ishte dhënë njoftimi më herët. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se Mbrojtja nuk kërkoi, për asnjë nga dëshmitarët, më shumë kohë për t'u përgatitur për pyetje shtesë pas pyetjeve të Trupit Gjykses. Së katërti, shumica e materialeve për të cilat është dhënë njoftim nga Trupi Gjykses kanë qenë në posedim të Mbrojtjes prej muajsh ose vitesh dhe mund të supozohet se kanë qenë të njohura për Mbrojtjen. Nëse Mbrojtja ka kërkuar nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(3), për të cilat ka pasur njoftim dhe/ose i ka rishikuar, materialet që i nxirren sipas rregullës 102(3), është pjesë e diskrecionit të Mbrojtjes. Trupi Gjykses nuk mund të fajësohet për vendimin e mbrojtësve për të mos vepruar në këtë mënyrë.⁹⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se ka vepruar sistematikisht me kujdes të shtuar duke u dhënë palëve dhe pjesëmarrësve njoftim për të gjitha dokumentet relevante për pyetjet e veta, edhe në rastet kur gjasa e përdorimit të tyre ishte e kufizuar, në mënyrë që Mbrojtja të jetë në gjendje të përgatitet në mënyrë të efektshme për pyetjet e Trupit Gjykses dhe, sipas rastit, të bëjë pyetje shtesë pas pyetjeve të bëra nga gjykatësit. Së fundi, në Urdhrin e vet për Materialet sipas Rregullës 102(3), Trupi Gjykses u shpreh se do të përpiqej t'u jepte palëve njoftim, përpara fillimit të marrjes në pyetje, për materialet nga sfera publike ose

⁹⁵ Transkripti i seancës, 19 mars 2024, f. 13381, rreshti 25 deri në f. 13382, rreshti 2.

për materialet e nxjerra për Mbrojtjen në përputhje me rregullën 102(3) dhe rregullën 103.⁹⁶ Për të vetmin shembull që jep Mbrojtja në mbështetje të pretendimit të saj për mungesë njoftimi,⁹⁷ Trupi Gjykses reagoi menjëherë ndaj problemeve të ngritura nga pyetjet e Mbrojtjes dhe bëri të qartë se do t'i kishte dhënë njoftim Mbrojtjes për materialin përkatës sipas rregullës 102(3), në rast se do të kishte pasur kohë për ta bërë këtë.⁹⁸ Mbrojtjes nuk iu shkaktua asnjë dëm, gjë që është e qartë nga fakti se: (i) mbrojtësi arriti të identifikonte dokumentin në fjalë; (ii) Mbrojtja nuk kërkoi më shumë kohë për t'u përgatitur; dhe (iii) Mbrojtja zgjodhi të mos i bënte pyetje të tjera dëshmitarit lidhur me këtë dokument. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtjes nuk iu shkaktua asnjë dëm.

45. Lidhur me mbështetjen e Trupit Gjykses në materialet sipas rregullës 102(3), disa prej të cilave janë me qindra faqe dhe nuk janë nxjerrë për disa nga ekipet e Mbrojtjes,⁹⁹ Trupi Gjykses vëren se, nga materialet sipas rregullës 102(3) dhe rregullës 103 për të cilat Mbrojtjes iu dha njoftim, është vetëm një dokument sipas rregullës 102(3)¹⁰⁰ dhe një dokument sipas rregullës 103¹⁰¹ që u përdorën gjatë pyetjeve që Trupi Gjykses i bëri dëshmitarit W03873. Dokumenti sipas rregullës 102(3) iu nxor Mbrojtjes më 30 janar 2023,¹⁰² dhe dokumenti sipas rregullës 103 iu nxor Mbrojtjes më 31 gusht 2022.¹⁰³ Trupi Gjykses vëren gjithashtu se është përgjegjësi e mbrojtësve të përgatiten për gjykimin dhe, siç u theksua më lart, vendimi nëse do të kërkohet nxjerrja (dhe rishikimi) i materialeve sipas rregullës 102(3), për të cilat Mbrojtjes i është dhënë njoftim, është përgjegjësi dhe diskrecion i vetëm i mbrojtësve të secilit prej të akuzuarve. Në këtë drejtim, Trupi

⁹⁶ Transkripti i seancës, 19 mars 2024, f. 13383, rreshtat 1-5; Transkripti i seancës, 5 qershor 2024, f. 16710, rreshti 16 deri në f. 16711, rreshti 3.

⁹⁷ Kundërpërgjigjja, poshtëshënimi 18.

⁹⁸ Transkripti i seancës, 18 nëntor 2024, f. 22354, rreshtat 20-22.

⁹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 10.

¹⁰⁰ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, p. 22870, rreshti 8 deri në p. 22871, rreshti 13.

¹⁰¹ Transkripti i seancës, 27 nëntor 2024, p. 22866, rreshti 9, f. 22875, rreshti 2.

¹⁰² Materiali i nxjerrë 659.

¹⁰³ Materiali i nxjerrë 418.

Gjykues vëren se kur ky material lidhet me marrjen në pyetje nga gjykatësit, Trupi Gjykues shpërndan një listë të materialeve sipas rregullës 102(3) dhe rregullës 103 që mund të përdoren gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykues dhe, në rast se jo të gjitha ekipet e Mbrojtjes janë në posedim të materialit përkatës, urdhëron ZPS-në të mundësojë nxjerrjen e tyre. Sërish, nëse mbrojtësi zgjedh ose jo të njihet me këtë material, kjo është zgjedhje dhe diskrecion i vetëm i tij/asaj. Lidhur me parashtrimet e Mbrojtjes se, në një çështje gjyqësore kaq të madhe sa çështja aktuale, nuk mund të pritët që Mbrojtja të ketë njohuri të plotë mbi relevancën e çdo materiali të nxjerrë sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103,¹⁰⁴ Trupi Gjykues vëren se materialet për të cilat palët marrin njoftim janë ato që vetë Mbrojtja ka kërkuar të marrë. Ato kanë kuadër të kufizuara dhe janë qartësisht të lidhura me dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar. Në asnjë moment gjatë marrjes në pyetje nga Trupi Gjykues, Mbrojtja nuk kërkoi më shumë kohë për të shqyrtuar dokumentet për të cilat Trupi Gjykues kishte dhënë njoftim, përpara se të bënte pyetje shtesë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues vlerëson se Mbrojtjes nuk i është shkaktuar asnjë dëm.

46. Mbrojtja gjithashtu pretendon se mbështetja e Trupit Gjykues në materialet sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103, të cilat nuk janë në listat e paraqitura të asnjërës palë dhe që shpesh lidhen me aspekte që nuk janë ngritur nga palët dhe/ose dalin jashtë kuadrit të Aktakuzës dhe Dosjes Paraprake të ZPS-së, krijon përshtypjen se Trupi Gjykues po procedon një çështje më vete.¹⁰⁵ Siç u theksua tashmë, Trupi Gjykues as nuk ka, as nuk po procedon një “çështje” më vete. Përgjegjësia e tij është të vlerësojë dhe, nëse është e nevojshme, të nxjerrë prova me qëllim që të mundësojë arritjen te e vërteta duke respektuar dhe duke marrë parasysh provat e paraqitura nga të dyja palët. Trupi Gjykues rikujton gjithashtu se provat për veprime për të cilat nuk është ngritur akuzë, mund të jenë të

¹⁰⁴ Kundërpërgjigjja, para. 9.

¹⁰⁵ Kundërpërgjigjja, para. 7.

papranueshme sa i takon vërtetimit të fajësisë për veprat penale të ngritura në aktakuzë, por mund të jenë të pranueshme për qëllime të tjera të vlefshme.¹⁰⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses përbëhet nga gjykatës profesionistë, të cilët janë të kualifikuar për të vlerësuar besueshmërinë e një dëshmitari dhe mbështetshmërinë në dëshminë e tij/saj. Vendosja e kufizimeve paraprake ndaj Trupit Gjykses në marrjen në pyetje të dëshmitarëve do të ndikonte seriozisht në rolin e tij si organ neutral për zbulimin e fakteve.¹⁰⁷ Mbrojtja u referohet në përgjithësi aspekteve që i konsideron jashtë kuadrit të Aktakuzës dhe Dosjes Paraprake të ZPS-së, pa referenca konkrete në dokumentacion.¹⁰⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është në gjendje t'i vlerësojë këto aspekte në kontekstin e tyre të duhur. Për të vetmin shembull konkret të cituar nga Mbrojtja,¹⁰⁹ Trupi Gjykses vëren se ishte ZPS-ja ajo që e ngriti fillimisht këtë incident me dëshmitarin W03873 gjatë marrjes së tij në pyetje.¹¹⁰ Mbrojtja nuk pati kundërshtime ndaj pyetjeve të Trupit Gjykses lidhur me këtë pikë. Rrjedhimisht, Mbrojtja nuk ka vërtetuar se Trupi Gjykses shkeli të drejtën e të akuzuarve për një proces të rregullt gjyqësor nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm, duke përdorur kompetencën e tij të gjerë diskrecionale për t'u bërë dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme për sqarimin e dëshmive të tyre ose për zbulimin e së vërtetës.

47. Lidhur me dokumentet e nxjerra për Mbrojtjen në përputhje me rregullën 103, për të cilat Trupi Gjykses ka dhënë njoftim sa i përket përdorimit ose relevancës së tyre të mundshme për marrjen në pyetje të dëshmitarit nga gjykatësit, Trupi Gjykses vëren se nuk ka pasur asnjë sugjerim se Mbrojtja mund të mos i kishte në posedim ose të mos ishte njohur me përmbajtjen e dokumenteve që ZPS-ja i kishte nxjerrë në përputhje me rregullën 103. Trupi Gjykses më tej

¹⁰⁶ Vendimi i Apelit, para. 53.

¹⁰⁷ Vendimi i Apelit, para. 53.

¹⁰⁸ Kundërpërgjigjja, poshtëshënimi 15.

¹⁰⁹ Kundërpërgjigjja, poshtëshënimi 23.

¹¹⁰ Transkripti i seancës, 25 nëntor 2024, f. 22632, rreshtat 11-25.

vëren se nxjerrja e një dokumenti sipas rregullës 103 është një tregues veçanërisht i rëndësishëm i relevancës dhe rëndësisë së mundshme të atij dokumenti për Mbrojtjen, pasi ka të bëjë me ‘provat shfajësuese’. Trupi Gjykses vlerëson gjithashtu se, pasi dokumentet u përdorën ose u morën në konsideratë nga Trupi Gjykses, Mbrojtja pati mundësinë të bënte pyetje shtesë lidhur me këto dokumente nëse nga pyetjet e Trupit Gjykses do të dilnin aspekte të reja. Mbrojtja gjithashtu pati mundësinë të kërkonte më shumë kohë për të marrë udhëzime nga klientët e saj lidhur me ndonjë prej këtyre dokumenteve ose për t’u përgatitur për pyetje. Mbrojtja nuk e bëri një gjë të tillë. Gjithashtu, Mbrojtja nuk paraqiti ndonjë pretendim tjetër lidhur me ndonjë dëm të supozuar.

48. Lidhur me pretendimin e Mbrojtjes se shpeshtësia e përdorimit të materialeve sipas rregullës 102(3) dhe rregullës 103 ka krijuar perceptim të arsyeshëm për anshmëri dhe për ndjekjen nga Trupi Gjykses të çështjes së vet,¹¹¹ Trupi Gjykses rikujton se gëzon një kompetencë të gjerë diskrecionale për t’u bërë dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme për sqarimin e dëshmimeve të tyre ose për zbulimin e së vërtetës.¹¹² Mbrojtja thekson me të drejtë¹¹³ se Paneli i Gjykatës së Apelit ka arritur në përfundimin që Trupi Gjykses mund të përdorë materiale sipas rregullës 102(3) dhe rregullës 103 gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve. Sërish, Mbrojtja nuk i referohet asnjë shembulli specifik ku vlerëson se Trupi Gjykses keqpërdori kompetencën e tij të gjerë diskrecionale për t’u bërë dëshmitarëve çdo pyetje që vlerësohet e nevojshme për sqarimin e dëshmimeve të tyre ose për zbulimin e së vërtetës. Sa i takon nëse Mbrojtjes i është shkaktuar ndonjë dëm, Trupi Gjykses rikujton se, në bazë të pyetjeve të bëra nga Trupi Gjykses,¹¹⁴ Mbrojtja ka të drejtë që, nëse është e nevojshme, të bëjë pyetje shtesë

¹¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 11.

¹¹² Vendimi i Apelit, para. 32.

¹¹³ Kundërpërgjigjja, para. 11.

¹¹⁴ Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 112.

ose të kërkojë më shumë kohë për të shqyrtuar dokumentet.¹¹⁵

49. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se njoftimi për materialet sipas rregullës 102(3) dhe rregullës 103 është kryer në përputhje me Ligjin, Rregulloren dhe urdhrat e mëparshëm të Trupit Gjykses. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtjes nuk i është shkaktuar asnjë dëm dhe se përdorimi nga ana e Trupit Gjykses i materialeve sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103 nuk do ta çonte një vëzhgues të arsyeshëm, të informuar siç duhet, në perceptim të arsyeshëm për anshmëri.

V. VENDIM

50. Për këto arsye, Trupi Gjykses ka marrë shënim kundërshtimet e Mbrojtjes të parashtruara në Kërkesë, dhe e **HEDH POSHTË** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 26 shkurt 2025

Hagë, Holandë.

¹¹⁵ Transkripti i seancës, 19 mars 2024, f. 13382, rreshtat 15-17.